

## KËRKESË PËR KORRIGJIMIN E TË DHËNAVE

**Kërkues:** Filip Talo, i biri i Grigorit (Ligor), i datëlindjes 14.07.1969, lindur në Lushnje dhe banues në Tiranë, Rruga "Preng Bib Doda", blloku "Vasil Shanto", Pall. Nr. 15, Tiranë.

**Drejtuar:** Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Nenet, 5, 39 dhe 40 të Ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

E nderuar Kryetare dhe të nderuar Anëtarë të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit.

Unë kërkuesi quhem Filip Talo.

Sic jeni në dijeni, pas kërkësës time për informacion në datë 27.07.2022, nga Autoriteti i Dosjeve, në datë 29.07.2022 më është vënë në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni i një dosje në ngarkim të personit tim.

**1)** Paraprakisht, më lejoni të sqaroj përpara jush, se jam thellësisht i indinjuar me mënyrën se si është menaxhuar informacioni personal dhe konfidencial nga ana e Autoritetit Tuaj, lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale të mia, si dhe me cënimin e pashembullt të nderit e dinjitetit tim familjar në rastin konkret.

Po ju citoj vetëm disa fakte të thjeshta për t'ju bërë me dije se Ju si Autoritet (në fakt besoj se e keni tashmë të qartë), në mënyrë flagrante i keni shkelur "Parimet" e përcaktuara në nenin 4 të Ligjit tuaj organik, sidomos parimet e përcaktuara në pikat *d) mbrojtjes së të drejtës për jetë private dhe të dhënave personale; dhe dh) mbrojtjes së të dhënave që përbëjnë informacion të klasifikuar;*, parime të cilat prezumohet se duhet të udhëheqin punën dhe funksionin e Institucionit tuaj. Gjithashtu, vlen të theksoj faktin se fatkeqësia ime në atë periudhë, nuk mund të shërbejë si bazë për të më bërë objekt ngacmimesh apo shantazhesh sot.

Më konkretisht ju bëj me dije se:


- 1) Në datë 26.07.2022 në një gazetë me shpërndarje kombëtare (shqiptarja.com) janë publikuar disa informacione, të cilat kanë nxjerrë të dhëna dhe indicie mbi dosjen time, por duke e manipuluar të vërtetën, pasi janë krijuar insinuata me orientim politik;
- 2) Në datë 27.07.2022 ekzaktësisht në momentin që unë kam qenë në Institucionin Tuaj nga ora 11.00 – 12.30, (**theksoj faktin se dosja në ngarkim të personit tim në këtë datë dhe orar ka qenë e padeklasifikuar ende nga Autoriteti Juaj**), në media audiovizive por dhe media on line është publikuar në mënyrë të plotë emri dhe mbiemri im, në kundërshtim flagrant me parimet që duhet të udhëhiqet dhe funksionojë Autoriteti Juaj;
- 3) Në datë 29.07.2022, pasi jam njoftuar nëpërmjet telefonit nga një punonjës i Autoritetit tuaj pér térheqjen e dosjes në ngarkimin tim, në ora 16:40 (pas orarit zyrtar të punës) sapo kam dalë nga Institucioni Juaj, jam përballur me media dhe gazetarë të ndryshëm të pajisur me kamera dhe mikrofonë në duar, të cilët kërkonin intervista. Përveç Institucionit tuaj, asnëjë person apo institucion tjetër nuk kishte dënu mund të kishte dijeni mbi prezencën time në atë orar specifik në Autoritetin e Dosjeve, vetëm në rast se do të ishte njoftuar nga dikush nga “brenda”.

FAKTEL dhe shkeljet e mësipërme, pavarësisht se i citova në mënyrë të përbledhur, ju bëj me dije se do të ndiqen në mënyrë ligjore nga ana ime.

**2)** Pasi jam njoftuar me materialet e dosjes në ngarkim të Personit tim, jam shokuar dhe tronditur njëkohësisht lidhur me përbajtjen e saj, veçanërisht lidhur me të dhënat në dokumente e shkresa të prodhura nga “punonjësit dhe zyrtarët e sigurimit të shtetit”, në raport këto me të vërtetën time. Në dokumentet që gjenden në dosjen time, rikonfirmoj, autenticitetin, saktësinë dhe vërtetësinë vetëm pér ato të dhëna në shkresat të cilat janë shkruar me shkrim dore dhe janë firmosur nga ana ime. Ndërkohë që disa shkresa të tjera përbajnjë të dhëna kontradiktore, të pasakta, të manipuluara dhe/ose të falsifikuara. Pavarësisht se unë e kuqtoj faktin që po tentohet përmes historisë time, të përfitohet politikisht, theksoj me forcë faktin se kjo nuk mund të arrihet përmes të pavërtetave dhe manipulimeve/falsifikimeve të të dhënave në dosjen time.

Më konkretisht, rikonfirmoj dhe risjell në vëmendjen tuaj në mënyrë kronologjike dhe analitike faktet, ngjarjet dhe të dhënat e jetës time në vitet 89-90 si më poshtë:

Në vitin 1988 kam fituar të drejtën e studimeve në Universitetin e Tiranës, dega Ekonomi Politike. Në fund të vitit të parë të shkollës, dhe sidomos gjatë vitit të dytë të Universitetit, duke qenë i pakënaqur me regjimin në fuqi, kam patur dëshirë të largohesh nga Shqipëria, (në atë kohë kjo dëshirë konsiderohej arratisje dhe ishte vepër e rëndë penale.) Këtë ide të timen e kam diskutuar vetëm me dy persona dhe konkretisht: Ilir Murati (SHOK I KURSIT TIM DHE SHOK KONVIKTI) dhe Astrit Zeqo (SHOK KONVIKTI).



Veçanërisht me Ilir Muratin kam zhvilluar disa biseda lidhur me mundësine e arratisjes jashtë shtetit, deri në momentin që kam dyshuar se Ilir Murati mund të ishte person që bashkëpunonte me sigurimin e shtetit.

Në datë 09.03.1990 jam ndaluar, nga Organet e Sigurimit të Shtetit. Punonjësi kryesor i Sigurimit të Shtetit që më ka marrë në pyetje, fillimisht nuk është prezantuar, por më pas kam mësuar se quhej Edmond Thimjo. Jam akuzuar verbalisht për veprimitari armiqësore kundër Pushtetit Popullor, si dhe jam akuzuar verbalisht për tentative arratisje, fakte të cilat me forcë i kam kundërshtuar. Rezistenca ime ka zgjatur për disa orë edhe pse nga punonjësit e sigurimit të shtetit jam kërcënuar unë personalisht, si dhe më janë përmendur kërcënime për prindërit dhe familjarë të tjerë të mi. Pasi punonjësit e sigurimit të shtetit nuk kanë mundur të më bindnin të pranoja “veprimitarinë time armiqësore”, pas disa orësh më kanë vënë përpëra denoncimin dhe përgjimet me teknikë operative të shokut tim të klasës Ilir Murati. Në këtë moment jam shokuar dhe jam prerë njëkohësisht, duke menduar skenarin më të keq për veten, për njerëzit e afërm, dhe sidomos skenarin që mund të ndiqnin për familjen time (nënën dhe babain). I ndodhur në rrethana shumë të vështira për jetën time, kam pranuar të bashkëpunoj me organet e sigurimit, duke e parë si zgjidhje rrethanore për momentin ku ndodhesha. Nga ky moment deri në Shkurt 1991, kohë në të cilën jam larguar nga Shqipëria, pra për afro 11 muaj, organet e sigurimit të shtetit megjithë përpjekjet e pareshtura që kanë kryer ndaj meje, nuk kanë mundur të më aktivizojnë për qëllime të tyre. Në fakt, nga muaji Dhjetor 1990 e deri shkurt 1991, pasi i kam informuar shokët e dhomës si dhe disa shokët të tjerë, këta më kanë ardhur në ndihmë sa herë që punonjësit e sigurimit të shtetit tentonin të më kontaktonin. Sqaroj faktin (dhe ju tashmë e dini me prova e fakte) se për asnjë moment nuk kam prodhuar asnjë produkt që mund ti shërbente organeve të sigurimit të shtetit.


Pasi jam njobur me të dhënat e dosjes time, rikonfirmoj edhe njëherë 100% deklarimet e mia në deklaratën e datës 09.03.1990 përpëra Organeve të Sigurimit të Shtetit, deklaratë e bërë me shkrimin tim dhe e firmosur nga unë, ku deklaroj se për arratisjen time jashtë shtetit kam biseduar vetëm me dy shokët e mi: Ilir Murati (SHOK I KURSIT TIM DHE SHOK KONVIKTI) dhe Astrit Zeqo (SHOK KONVIKTI).

Ndërkohë që, dosja në ngarkim të personit tim, ndër të tjera përmban dy dokumente të “produara” nga organet e sigurimit të shtetit dhe konkretisht:

- 1) Dokumenti “*Vendim për të térhequr në rrjetin informativ të OSSH me bazë detyrimi të objektit Filip Talo*”;
- 2) Dokumenti “*Relacion për studimin e dosjes të përpunimit aktiv në ngarkim të Filip Talo*”.

Pasi kam lexuar me vëmendje të dy këto dokumente, konstatoj se ato përbajnë të dhëna të pasakta, dhe/ose të manipuluara apo të falsifikuara.

Më konkretisht, ju bëj me dije se:



Në dokumentin “*Vendim për të térhequr në rrjetin informative të OSSH me bazë detyrimi të objektit Filip Talo*” kam konstatuar këto të dhëna të pasakta, dhe/ose të manipuluara apo të falsifikuara.

- 1) Në faqen “2” pragrafi “II” të këtij dokumenti citohet: *Objekti Filip Talo është marrë në përpunim paraprak më 23.01.1989 mbi bazën e denoncimeve të studentëve Ilir Murati dhe Ilir Metaj dhe me vërtetimin e tyre me teknikë operative më 23.04.1989.*

Ky citim është i pasaktë dhe/ose i manipuluar apo i falsifikuar për arsy se:

- Shokët e vetëm me të cilët unë kam biseduar për arratisjen time jashtë shtetit janë dy dhe konkretisht Ilir Murati (SHOK I KURSIT TIM DHE SHOK KONVIKTI) dhe Astrit Zeqo (SHOK KONVIKTI);
- Denoncimi i vetëm që më është vënë përpara nga punonjësit e sigurimit të shtetit është vetëm denoncimi i shokut tim të klassës dhe konviktit Ilir Murati (denoncim i cili çuditërisht mungon në dosje).
- I vetmi person që ka përdorur ndaj meje teknikë operative është shoku im Ilir Murati dhe ky fakt është i konfirmuar nga organet e sigurimit të shtetit në dokumentet dhe përgjimet që më kanë vendosur përpara në datë 09.03.1990 (dokumente të cilat çuditërisht mungojnë në dosje).
- Ju informoj se në klasën time ka patur dy persona me emrin Ilir Metaj dhe konkretisht: Ilir Rexhep Metaj dhe Ilir Mero Metaj. Sqaroj faktin se në asnjë rrethanë apo situatë unë nuk kam biseduar me asnjë prej tyre për idenë e arratisjes jashtë shtetit, si dhe asnjë prej këtyre dy personave nuk më ka pyetur apo shprehur ndonjë kërkesë apo dyshim lidhur me idenë time për t'u arratisur. Ky fakt konfirmohet edhe nga dokumentet që më kanë vënë përpara punëtorët dhe operativët e sigurimit të shtetit ku rezultonte vetëm një person si denoncuesi im dhe ai ishte: Ilir Murati.

Sa mësipër, unë kërkuesi Filip Talo, kërkoj korrigjin/saktësimin e këtij paragrafi duke qartësuar faktin se personi i Vetëm që më ka denonuar me prova, fakte dhe përgjime në organet e sigurimit të shtetit është Ilir Murati.

- 2) Në faqen “2” paragrafi “VI” të këtij dokumenti citohet: *për objektin Filip Talo ka denonuar edhe studenti Ilir Metaj, i cili bisedat armiqësore të zhvilluara prej Filipit, i ka mësuar prej denoncuesit Ilir Murati, pasi janë shokë kursi me njëri tjetrin dhe me objektin.*

Ky citim është i pasaktë dhe/ose i manipuluar apo i falsifikuar për arsy se:

- Së pari citimi në paragrafin “VI”, fq 2 bie në kundërshtim me citimin e punonjësit operativ në paragrafin “II”, faqe “2” pasi: në paragrafin “II” citohet se “denoncuesi Ilir Metaj” e ka vërtetuar denoncimin e tij me teknikë operative, ndërkohë që në paragrafin “VI” të po të njejtës faqe, të të njejtët dokument, citohet se “studenti Ilir Metaj” i ka mësuar “bisedat armiqësore prej denoncuesit Ilir Muratit”. Qartazi kemi një dualitet, përplasje dhe kontradiktë frazash në faqen 2 të këtij dokumenti, pasi nga njëra anë Ilir Murati është qartazi denoncues ndërkohë që “studenti” Ilir Metaj njëherë përmendet si denoncues (madje edhe me teknikë operative), kurse nga ana tjetër po disa paragafe

- mëposhtë të të njejtë dokument, përmendet fakti se studenti Ilir Metaj e ka mësuar veprimtarinë armiqësore nga denoncuesi Ilir Murati. Pra, rezultojnë përplasje, thënie dhe cilësimë kontradiktore, në një dokument të prodhuar nga organet e sigurimit të shtetit. Ju jeni Autoriteti përgjegjës dhe keni tagrin të vlerësoni për këto "lajthitje";
- b) Së dyti e rikonfirmoj edhe njëherë autenticitetin e deklaratave të dhëna me shkrim përpara punonjësve të sigurimit të shtetit në datë 09.03.1990 ku rezulton se:  
Unë Filip Talo, jam denonuar në organet e sigurimit të shtetit vetëm nga një person dhe ai është Ilir Murati.

Sa mësipër, unë kërkuesi Filip Talo, kërkoi korrigjimin/saktësimin e këtij paragrafi duke qartësuar faktin se personi i Vetëm që më ka denonuar me prova, fakte dhe përgjime në organet e sigurimit të shtetit është Ilir Murati.

- 3) Në faqen "3" paragrafi "III" të këtij dokumenti citohet: *Nga informacioni i T.O. dt. 2.3.1989 del se objekti Filip Talo i shprehet denoncuesit Ilir Metaj ndër të tjera se: "... ne do të arratiseshim, kështu e kishim llogaritur... s'u hapa shumë (me ty) e përderisa nuk u hap ky muhabet nuk kishe përsë të dije më shumë... unë këtë muhabet e kam bërë vetëm me ty, me dhe të tjerët nuk ke punë fare...këtë muhabet me ty e bëra në formë shoqërore dhe mora mendimin tënd....jemi 5-s veta, pesë shokë....por t'i nuk i njeh mor burrë, ikim direkt...është edhe një tjetër me ne, ti nuk e njeh fare atë dhe as ai nuk të njeh ty. Mua më ka dërguar lajm që ai muhabeti ka për t'u bërë.... këtë shokun e Durrësit e njoh më mirë...por unë për vehte kam hequr dorë, ta thashë edhe atë ditë, me ty nuk ka punë njeri... Kur denoncuesi e pyet nëse ka biseduar me ushtarin e Sarandës, objekti thotë: "...unë e di që atëherë.. por ai nuk e di muhabetin fare për atë punë.. ai tha që të arratisemi, të ikim. Po ka besë ai....".*

Ky citim është totalisht i pavërtetë dhe i manipuluar/falsifikuar, për arsy se:

- a) Së pari konfirmoj se këtë bisedë e kam bërë vetëm për vetëm me Ilir Muratin, në një lokal afér Qytetit Studenti. Madje edhe sot e kujtoj me saktësi lokalin ku është zhvilluar kjo bisedë. Ilir Murati kishte marrë me vehte edhe dy shishe me verë të kuqe Librazhdi, dhe kishte si synim të më jepte për të pirë me qëllim që unë të flisja/hapesha për çdo pyetje që ai do të bënte. Pikërisht ky ka qenë momenti, që unë kam kuptuar se Ilir Murati ishte bashkëpunëtor i sigurimit të shtetit dhe ishte i pajisur me përgjues. Qëndrimi im ka qenë refuzues si ndaj pijes ashtu edhe ndaj gjithë pyetjeve që më bënte Ilir Murati. Sqaroj dhe konfirmoj faktin se të gjitha këto pyetje siç janë cituar në faqen "3" paragrafi "III" të Dokumentit "Vendim për të têrhequr në rrjetin informativ të OSSH me bazë detyrimi të objektit Filip Talo", mua Filip Talo më janë bërë nga shoku im Ilir Murati.
- b) Ky fakt, konfirmohet edhe në vazhdimin e përshkrimit të kësaj situate, ku në dokument citohet se: *Aktualisht objekti paraqitet i têrhequr por në qëndrimin e tij duhet të ketë influencuar edhe ndonjë dyshim për pozitën e denoncuesit....*

Siq edhe e sqarova mësipër, ky është momenti që kam kuptuar se Ilir Murati po më provokonte qëllimi si bashkëpunëtor i sigurimit, dhe unë jam tërhequr.

Nga ana tjetër, përvèç dy personave Ilir Murati dhe Astrit Zeqo, rikonfirmoj faktin se asnjëherë nuk kam bërë biseda arratisje jashtë shtetit me ndonjë person tjetër në klasën time;

- c) Ky fakt konfirmohet në mënyrë të qartë dhe shterues edhe me deklaratën time të datës 09.03.1990 të bërë me shkrim dore dhe firmosur nga unë, përpara organeve të sigurimit të shtetit dhe konkretisht:


Në deklaratën time me shkrim dore deklarohet përpara organeve të sigurimit të shtetit se personat e vetëm me të cilët kam biseduar për t'u arratisur jashtë shtetit janë: Ilir Murati dhe Astrit Zeqo. Më konkretisht në një nga këto biseda, siq deklarohet në faqen 2 citohet se: *bisedat e tjera që bëja me Ilirin qoftë edhe me Astritin lidhur me ushtarin që do të më ndihmonte (është shkruajtur dy herë kjo) që do të më ndihmonte për t'u arratisur nga Saranda e të tjera, këto më shumë si biseda i bëja për t'i mbushur mendjen Ilirit dhe Astritin...*

Ky fakt provon dhe konfirmon në mënyrë të qartë dhe shterues se personat e vetëm që unë kam bërë biseda arratisje jashtë shtetit janë Ilir Murati dhe Astrit Zeqo. Edhe biseda për "ushtarin e sarandës" nga deklarimet e mia rezulton e qartë se është bërë me Ilir Muratin. Lidhur me të dhënat e pasqyruara në faqen "3" paragrafi "III" të Dokumentit "Vendim për të térhequr në rrjetin informativ të OSSH me bazë detyrimi të objektit Filip Talo", tashmë rezulton e qartë se minimumi janë të pavërteta dhe maksimumi janë të manipuluara/falsifikuara.

Sa mësipër, unë kërkuesi Filip Talo, kërkoj korrigjin/saktësimin e këtij paragrafi duke qartësuar faktin se personi i Vetëm që më ka denoncuar me prova, fakte dhe përgjime në organet e sigurimit të shtetit është Ilir Murati.

- 4) Në dokumentin "*Relacion për studimin e dosjes të përpunimit aktiv në ngarkim të Filip Talos*" citohet se: "*Vetë Filipi është marrë në përpunim P.P. më 23.1.1989, mbi bazën e denoncimeve të studentëve Ilir Murati dhe Ilir Metaj dhe me vërtetimin e tyre me T.O. është ngritur në përpunim aktiv më 23.04.1989*".

Bazuar mbi gjithë faktet, deklarimet, argumentet dhe sqarimet e cituara mësipër, unë kërkuesi Filip Talo, rikonfirmoj përpara Autoritetit të Dosjeve se personat e vetëm që kam biseduar për arratisje jashtë shtetit janë Ilir Murati dhe Astrit Zeqo. Denoncuesi im i vetëm që ka depozituar edhe deklarimet e tij edhe përgjimet e kryera ndaj meje (të konfirmuara me dokumente nga organet e sigurimit të shtetit) është Ilir Murati.



E nderuar Kryetare dhe Anëtarë të Autoritetit të Dosjeve,

Në nenin 39 “Kërkesa për korrigjime”, të Ligjit 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” parashikohet se: *Neni 39*

1. Kur kërkuesit e dokumenteve, sipas përcaktimeve të këtij kreu, si dhe personat e përmendur në to konstatojnë se në dokumentet dhe të dhënrat e vëna në dispozicion nga Autoriteti ka pasaktësi, ata vënë në dijeni Autoritetin, duke paraqitur kërkuesë për korrigjin e të dhënave.

2. Kërkesa për korrigjin e të dhënave përmban evidentimin e plotë të informacionit të pasaktë, arsyet e vlerësimit të këtij informacioni si të pasaktë, identifikimin e pjesëve ku ka vend për saktësimet, si dhe të dhëna apo dokumente që vërtetojnë pretendimet për pasaktësi dhe që ndihmojnë në saktësimin e informacionit. Kur kërkuesi nuk disponon të dhëna apo dokumente të tilla, por është në dijeni të vendndodhjes së tyre, ai vë në dijeni Autoritetin për këtë fakt.

Më tej akoma, në nenin 40 “Korrigimet” po të Ligjit 45/2015 përcaktohet se: *Neni 40*

1. Me marrjen e një kërkese, sipas nenit 39, të këtij ligji, Autoriteti vihet në lëvizje për të verifikuar pretendimet e kërkuesit.

2. Kur nga dokumentet e paraqitura nga kërkuesi, sipas pikës 2, të nenit 39, të këtij ligji, apo nga kërkimet e Autoritetit provohet pretendimi për pasaktësi, Autoriteti bën korrigimet përkatëse në dokumentin e prodhuar nga vetë Autoriteti, një kopje e të cilit i bashkëngjitet dokumentit origjinal. Në çdo rast korrigimi bëhet me vendim të arsyetuar dhe mund të ankimoset në gjykatën kompetente për gjykimin e çështjeve administrative.

3. Dokumentet e korriguara, sipas këtij nenit, ruhen dhe vihen në dispozicion, në të ardhmen, së bashku me korrigimet përkatëse.

Në këto kushte, bazuar në gjithë arsyetimin si mësipër, si dhe referuar bazës ligjore të sipërcituar, me anë të kësaj kërkese, kërkoi korrigjin/saktësimin e të dhënave në dosjen në ngarkim të Personit tim, duke saktësuar/qartësuar faktin se personi i Vetëm që mua Filip Talo më ka denoncuar me prova, fakte dhe përgjime në organet e sigurimit të shtetit është Ilir Murati.

Gjithashtu, me anë të kësaj kërkese, kërkoi nga institucioni Juaj, të zbatoni me korrekësia ligji, duke ju bërë me dije paraprakisht, se çështjen time do ta ndjek edhe në institucionet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Me respekt,

Kërkues

Filip Talo